

Shënimet Shpjeguese

1 Informacion i përgjithshëm

Shoqëria **Ujesjelles Kanalizime Elbasan SH**. A është themeluar me datë 24/06/2014, me aksionere Bashkia Elbasan me 100 % të kapitalit. Shoqëria është e regjistruar si person juridik i tatueshem pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan me numër identifikimi të personit të tatueshem L43121201L. Selia qendrore e shoqërisë ndodhet Lagjja Brigada 17 Sulmuese, rruga Petraq Popa, ish konvikti i Shkolles "Onufri", (kati I). Në vitin 2018 kjo shoqëri ka përthithur Ujsjelles Kanalizime Fshat Elbasan.

Objekti kryesor i aktivitetit të shoqërisë është: *Sherbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhim dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatoreve. Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajnimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij. Mirembajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre.*

Aksioner i vetëm i shoqërisë është Bashkia Elbasan e cila zotëron 100% të aksioneve. Kapitali i Shoqërisë Ujesjelles Kanalizime Elbasan SH.A është 2,145,432,331 lekë përbehet nga 1 aksion me vlerë nominale të aksionit 2,145,432,331 lekë

Drejtuesit e Shoqërisë janë si më poshtë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Administratori i Shoqërisë

Këshilli Mbikëqyrës i UJSJELLES KANALIZIME ELBASAN-sha në datë 31 dhjetor 2019 përbëhet si më poshtë:

1	Adi QOSE	Kryeta
2	Luan Dervishi	Anëtar
3	Qemal TUSHA	Anëtar

Administratori i shoqërisë: Luan Dervishi

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 333 punonjës (2018: 330 punonjës) ndërsa Numri mesatar i punonjësve është 325 punonjës.

Pagesat e drejtimit për vitin 2019 janë 2,763,673 lekë

Pagesat për Auditimin në vitin 2019 janë 1,620 mijë lekë

2 Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Deklarimet financiare të bashkangjitura janë përgatitur në baze të rregjistrimeve kontabel të mbajtura për qëllime të kontabilitetit të vendit konform Ligjit 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare të fund vitit janë paraqitur në formatin e paraqitur në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit në fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve të kontabilitetit në Shqipëri deklarimet financiare janë përgatitur mbi bazën e konceptit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Përgatitja e pasqyrave Financiare në përputhje me kërkesat e SKK, kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kontabile të rendesishme. Kjo gjithashtu kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të japë gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile të saj. Fushat të cilat kërkojnë një shkallë të lartë ose komplekse të gjykimit ose ato për të cilat vlerësimet apo supozimet janë të rendesishme për hartimin e pasqyrave financiare paraqiten në shënime.

Shpenzimet që lidhen me të ardhurat e fituara gjatë periudhës raportuese njihen në të njëjtën periudhë kontabel si dhe të ardhurat përkatëse.

Shpenzimet e kryera gjatë një periudhë raportuese, që ndryshon nga periudha kur ato i sjellin përfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht në periudhën kur merren përfitimet.

Mbajtja e kontabilitetit, i cili përfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen në mënyrë të kompjuterizuar, me anë të një programi të kontabilitetit alpha si dhe Programin e shitjes Faturim e arketim.

2.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e parimit të vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

Shumat janë paraqitur në Leke përveç rasteve ku citohet ndryshe.

2.4 Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.4.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të

termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.4.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.4.3 Zhvlerësimi i inventarëve

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

Nje permbledhje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

2.5 Instrumentat financiare

Kompania ka vetem instrumenta financiare jo derivative, perfshire dhe kerkesa nga kliente dhe kerkesa te tjera, mjete likuide dhe te ngjashme me to, huamarrje dhe huadhenie, furnitore dhe te tjera detyrime.

Instrumentat financiare jo-derivative njihen, fillimisht, me vleren e drejte plus, çdo kosto te drejtperdrejte transaksioni te lidhura me to, pervec atyre te pershkruara me poshte. Ne vazhdim te njohjes fillestare instrumentat financiare vleresohen si me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese kompania eshte pale ne kushtet e kontrates. Aktivet financiare nuk njihen nese te drejtat e Kompanise mbi rrejdhat e ardhshme te parase te gjeneruara nga aktivi financiar kane mbaruar ose nese kompania i transferon aktivite financiare nje pale te trete pa mbajtur te drejtat e kontrollit ose ne thelb te gjitha rreziqet dhe perfitimet nga aktivi. Blerja dhe shitja normale e aktiveve financiare kontabilizohet ne daten e shitblerjes psh. daten ne te cilen kompania vendos vete te bleje apo te shese aktivet. Detyrimet financiare nuk njihen me, nese detyrimet e Kompanise te specifikuar ne kontrate mbarojne afatin ose shlyen ose anulohen.

Mjetet Monetare

Zeri para ne dore dhe te ngjashme perfshin parate ne dore, depozita rrjedhese ne banka, te tjera investime afatshkurtra shume likuide me afat maturimi tremujor ose me pak.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar afatshkurtera jane paraqitur ne bilanc me kosto te amortizuar, pra me vleren e koston se tyre minus provizionet e krijuara per renie ne vlere. Provizione te

lejuara mund të llogariten, për shumën e vlerësuarë si të rikuperueshme, në fitim humbje kur ekziston një evidence objektive që këto kërkesa janë zhvlerësuar me pare.

Detyrime të pagueshme

Detyrimet për tu paguar dhe të tjera detyrime paraqiten me vlerën e drejtë të tyre dhe me pasmaten me vlerën e tyre të amortizueshme.

Huata bankare dhe të tjera

Në vazhdim të njohjes fillestare, huata bankare dhe të tjera paraqiten me kosto të amortizueshme duke njohur çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së rikuperueshme në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huamarrjes në bazë të një interesi efektiv.

Të tjera

Të tjera instrumenta financiare jo-derivative maten me kosto të amortizueshme duke përdorur metodën e interesi efektiv, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare sqarohet në pikën 2.8.

Aktivitetet financiare klasifikohen si detyrime afatshkurtra përveç rasteve kur kompania ka të drejtë të pakushtëzuar të ndryshojë marrëveshjen e huasë për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit.

2.6 Inventaret

Inventaret maten fillimisht me kosto. Pas njohjes fillestare të tyre Shoqëria vlerëson inventarin me vlerën e ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme i referohet vlerës neto që njësi ekonomike raportuese pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit.

Inventaret i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e mbylljes së bilancit. Shuma e zhvlerësimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ka faktore objektive që tregojnë që inventaret janë zhvlerësuar.

2.7 Aktivet Afatgjata Materiale

Në bilanc AAM paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Aktivitetet Afatgjata Materiale janë vlerësuar me koston e blerjes dhe kosto të tjera të drejtperdrejta që lidhen me sjelljen e aktivitetit në kushtet e nevojshme për funksionimin e tij.

Metoda për llogaritjen e amortizimit është mbi bazën e metodës zbritëse.

Toka dhe Ndërtimet në Proces, si dhe parapagimet furnitoreve nuk amortizohen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit përcaktohen nga krahasimi i përfitimeve me vlerën e tyre kontabel. Këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2.8 Aktivet Afatgjata Jo-Materiale

Shoqëria nuk zoteron Aktive Afatgjata Jo Materiale

2.9 Kuotat e kapitalit

Aksionet njihen si kapital. Kuota e aksionit është një dhe njihet me vlerën nominale të kapitalit.

2.10 Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlerat kontabile të aktiveve jo financiare të Kompanisë, përfshijë inventarët dhe tatimet të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi për të parë nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabile e një aktivi është më e madhe se vlera e rikuperueshme e tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi është më e madhja mes vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në matjen e vlerës në përdorim, flukset e pritshme të parës skontojnë në vlerën e aktuale duke përdorur normën e skontimit përpara takses që paraqet vlerësimin e tregut për vlerën në kohë të parës dhe riskun specifik të aktivitetit. Për humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohet në çdo datë raportimi nëse ka ndonjë tregues sipas të cilit humbja është ulur ose nuk ekziston më. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse kanë ndodhur ndryshimet në vlerësimet e bera për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi anulohet deri në atë masë që vlera kontabel e aktiveve të mos kalojë vlerën kontabel të aktiveve, minus amortizimin, që do të ishte përcaktuar nëse zhvlerësimi nuk do të kishte ndodhur.

2.11 Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ekzistojnë tregues sipas të cilëve një ose disa ngjarje kanë pasur një ndikim negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parës prej atij aktivi.

Humbja nga zhvlerësimi në rastin e një aktivi financiar të vlerësuar me kosto të amortizuar llogaritet si difference midis vlerës kontabel (neto) dhe Vlerës aktuale të flukseve të pritshme të parës të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktive financiare të një rendësie të vecantë testohen për zhvlerësim në mënyrë të vecantë. Pjesa tjetër e aktiveve vlerësohen së bashku, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Humbja nga zhvlerësimi mund të anulohet nëse ajo mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi njohjes së zhvlerësimit. Për aktivet financiare të vlerësuara në kosto të amortizuara anulimi i zhvlerësimit njihet në fitim humbje.

2.12 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë

vetëm vlerën e drejte të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga shitja e mallrave dhe shërbimeve gjatë aktivitetit të zakonshëm të Kompanisë.

Te ardhurat përfshijnë shumat neto pa përfshire shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar, të cilat nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto.

Ne lidhje me shitjen e mallrave, te ardhurat janë njohur kur ndryshimi i pronësise së bashku me riskun që vjen nga ky ndryshim, janë transferuar tek blerësi.

2.13 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur mbi bazën e të drejtave të konstatuara. Shpenzimet për kërkime e zhvillime përgjithësisht janë ngarkuar në llogarinë e shpenzimeve në periudhën në cilën i përket.

2.14 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare përbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara në bankë, fitimet nga shitja aktiveve financiare të mbajtura për shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atëherë kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet për interesat nga huatë, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvlerësimet e aktivave financiare. Gjithë kostot e huamarrjeve njihen në humbje fitime mbi bazën e përdorimit të metodës së interesit efektiv.

2.15 Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre

Shpenzimi (e ardhura) tatimore përmban shpenzimin tatimor aktual (të ardhurën tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor të shtyrë (të ardhurën tatimore të shtyrë). Shpenzimet që lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur ai lidhet me zërat e kapitalit dhe në këtë rast paraqitet direkt në kapital.

Shpenzimi tatimor aktual është shuma e tatimit që pritët të paguhet bazuar në te ardhurat e vitit ushtrimor, shkallën tatimore që zbatohet në ditën e raportimit si dhe cdo korigjim të detyrimeve tatimore të viteve paraardhëse. Tatimi i shtyre njihet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit, duke marrë si diferencë të perkohshme diferencat midis bazës tatimore të një aktivi ose pasivi dhe vlerës së tij kontabël neto në bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar në shkallën tatimore, të përcaktuar nga ligjet që janë në fuqi, që pritët të jetë e zbatueshme në momentin kur diferencë e perkohshme do të zhdukët.

Kompania njeh aktivin për tatim të shtyrë vetëm për atë sa është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme jenë të disponueshme kundrejt të cilave të mund të përdoret aktivi tatimor i shtyrë. Vlera kontabël e një aktivi tatimor të shtyrë duhet të rishikohet në çdo datë të bilancit. Një njësi ekonomike do të zvogëlojë vlerën kontabël të një aktivi tatimor të shtyrë për atë sa nuk ka më mundësi që fitim i tatueshëm i mjaftueshëm të jetë i disponueshëm për të lejuar përfitimin e përdorimit të një pjese ose të gjithë atij aktivi tatimor të shtyrë. Çdo

zvogëlim i tillë do të rimerret deri në masën që bëhet i mundur disponimi i fitimit të tatueshëm të mjaftueshëm.

2.16 Përfitimet e punonjësve

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

2.17 Transaksionet me monedhat e huaja

(a) Monedha e përdorur dhe raportuese

Zerat e përfshirë në pasqyrën financiare të secilës prej njësive ekonomike të grupit maten në monedhën bazë të mjedisit ekonomik në të cilën njësia ekonomike vepron (monedha në përdorim). Pasqyrat e financiare raportohen në Leke (ALL), e cila është monedha e përdorur dhe raportuese e Kompanisë.

(b) Transaksionet dhe Gjendjet

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën e përdorur duke përdorur kurset e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve në monedhe të huaja dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve në monedhe të huaja me kursin e këmbimit të fund-vitit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit me të rendesishme janë :

	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Euro	121.77	123.42

3 Mjete monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Banka	84,092,529	543,001
Arka		51,172,293
Totali	84,092,529	51,715,294

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhenat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me tepricat e llogarive bankare dhe inventaret fizike të mjeteve monetare në arken e kompanisë. Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëposhtëm i këtij instrumenti financiar është bërë në përputhje me paragrafet nr 11-21 të SKK-se së përmirësuar nr.3 "Instrumentat Financiare".

Shoqëria ka llogari bankare në Bankën Kombëtare Tregtare, Raiffaisen Bank, Pro Credit Bank, Otpbank, Tirana Bank, Alpha Bank, Union Bank dhe Credins Bank.

4 Të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti

Balanca e llogarive të arkëtueshme nga aktiviteti shfrytëzimit të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme		
Deri 1 vit	89,443,471	78,172,127
Mbi 1 vit	431,228,618	258,757,784
Zhvlerësimi kerkesave te arkëtueshme	-285,929,652	-94,961,770
Totali	234,742,437	241,968,141

Ne kete vit shoqeria ka korigjuar te drejtat per tu arkëtuar dhe llogarin e zhvlerësimit të kerkesave të arkëtueshme duke e barazuar atë me sistemin e faturim arkëtimit. Ne vitet e kaluara zhvlerësimi illogarive të arkëtueshmeve kishte prekur direkt llogarin e të arkëtueshmeve dhe jo llogarin e zhvlerësimit të tyre.

Lëvizjet në zhvlerësimin e të drejtave për arkëtim :

	2019	2018
Gjendja më 1 janar	94,961,770	86,961,770
Rimarrje për vitin	26,212,612	8,000,000
Korigjim Zhvlerësimi per vitet e kaluara	164,755,270	-
Gjendja më 31 dhjetor	285,929,652	94,961,770

Llogaritë e arkëtueshme nga aktiviteti të shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Familare te vitit	75,873,422	65,663,080
Familare mbi nje vitit	390,489,468	304,036,671
Biznese te vitit	12,999,480	12,023,046
Biznese mbi nje vitit	39,723,539	36,417,112
Institucione te vitit	570,569	486,001
Institucione mbi nje vitit	1,015,611	879,324
	520,672,089	419,505,234

5 Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Arketimet nga posta	2,285,476	0
Arketime nga arka Easy PAY	64,851	0
arketime nga AK Invest	125,391	0
Takse permbarimore	2,075,404	1 061 753
Shperblim demi (Albstar, BWI)	19,862,609	19 862 609
Detyrime punonjes te larguar	8,124,031	8 124 031
Raporte	531,390	531 390
Debitor te tjere		4 021 131
Arketim Qendera klienteve		999 448
	33,069,152	34 600 362

Ne aktive te tjera , shuma 2,285,476 leke, 64,851 dhe 125,391 paraqet te drejtat e shoqerise ,qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale te te treteve te lidhura midis Shoqerise UJSJELLES KANALIZIME ELBASANsha dhe kontraktoreve, per arketimin e detyrimeve te ujit te arketuara nga ata dhe te pa derdhura ne llogarin e shoqerise.

Detyrimet e tjera paraqisin detyrimet per punonjes te larguar te lene nga kontrolli shtetit qe para vitit 2014.

Ne zerin "Te drejta te arkëtueshme" jane pasqyruar te drejtat (llogaritë e arkëtueshme) qe njesia ekonomike ka ndaj te treteve si pasoje e aktivitetit te shfrytezimit, ku permendim Klientet e paarketuar ende ne daten 31.12.2019. Njohja e aktiveve financiare, matja fillestare dhe vleresimi i mepasshem i tyre realizohet duke mbajtur ne konsiderate kerkesat e SKK e permiresuar nr 3 "Instrumentata Financiare", paragrafet nr 11-21. Per vleresimin e tyre eshte perdorur metoda e koston se amortizuar

6 Inventarë

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2019 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	70,159,119	59,771,549
Materiale Ndhimese dhe Lende Djegese	214,664	1,374,586
Iventar I Imet	946,717	
Mallra	1,059,775	1,061,532
Totali	72,380,274	62,207,667

Shoqeria ka kryer inventarizimin me 31/12/2019 dhe nuk ka konstatuar mallra stoqe dhe me qarkullim te ngadalshem, dhe shoqeria nuk ka llogaritur zhvleresim te tyre.

UJSJELLES KANALIZIMEELBASAN sh.a

Pasqyrrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

7 Aktivet afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale përbëhen si më poshtë:

Kosto	Toka	Ndërtesa	Rrjeti shpërndarës & Kanalizime	Makinëri dhe impiante	Pajisje Zyre & Informatike	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	0	168,443,853	1,269,386,059	78,224,819	63,846,004	1,579,900,735
Shtesa	18,867,322	80,211,804	436,796,364	65,662,274	1,782,720	603,320,484
Pakësime	-	-	-	-	-	0
Riklasifikime midis grupeve	-	-	-	-	-	0
Gjendja më 31 dhjetor 2018	18,867,322	248,655,657	1,706,182,423	143,887,093	65,628,724	2,183,221,219
Shtesa	-	-	514,412,821	3,494,000	3,570,610	521,477,431
Pakësime	-	-	-	-	-	0
Riklasifikime midis grupeve	-	-	-	-	-	0
Gjendja më 31 dhjetor 2019	18,867,322	248,655,657	2,220,595,244	147,381,093	69,199,334	2,704,698,650
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2018	-	22,545,553	164,701,335	40,046,391	23,811,401	251,104,681
Amortizimi i përtudhës	-	8,249,799	55,280,965	12,936,882	8,074,270	84,541,916
Shtesa	-	3,821,118	19,793,772	5,371,285	642,571	29,628,746
Riklasifikime midis grupeve	-	-	-	-	-	0
Gjendja më 31 dhjetor 2018	0	34,616,470	239,776,072	58,354,558	32,528,242	365,275,343
Amortizimi i përtudhës	-	10,701,959	73,033,087	6,419,501	7,016,221	97,170,768
Pakësime	-	-	-	-	-	0
Riklasifikime midis grupeve	-	-	-	-	-	0
Gjendja më 31 dhjetor 2019	0	45,318,429	312,809,159	64,774,059	39,544,463	462,446,111
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2018	18,867,322	214,039,187	1,466,406,351	85,532,535	33,100,482	1,817,945,876
Gjendja më 31 dhjetor 2019	18,867,322	203,337,228	1,907,786,085	82,607,034	29,654,871	2,242,252,539

Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesipërme janë të perputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2019. Për trajtimin kontabel gjatë dhe në fund të periudhës raportuese, që nga momenti i njohjes për here të parë në librat kontabel, duke vijuar me tej me matjen e vlerësimit të tyre në dalje dhe në datën e raportimit financiar me metodën e Kostos së Amortizuar, në përputhje me SKK nr 5 "Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale" e përmirësuar, paragrafet 8-54.

Pasqyrimi i tyre në PF është bërë me Vlerën Kontabel Neto (VKN) në datën e raportimit. Përlogaritja e shpenzimeve të amortizimit është mbështetur në kërkesat e Ligjit nr 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, nen 22, sipas metodës së përqindjes mbi vlerën e mbetur, përkatesisht për AAM në pronesi të Ujesjelles Kanalizime Elbasan SH.A., dy kategoritë kryesore janë referuar referuar pikës 3 të Ligjit të sipërpermendur "ndërtesa, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të rrjetit ujësjetel dhe kanalizime, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi" me 5%, dhe pikës 5 (b) "Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë me 20%", pajisje informatike 25%.

Shoqëria ka shtuar asetet dhe me fonde të të treteve të Bashkisë Elbasan në vlerë 37,023,565 lekë dhe nga AKUM 474,306,310 lekë

8 Llogari të pagueshme afatshkurtra

Llogari të pagueshme afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitore	337,847,812	267,799,840
Të pagueshme ndaj punonjësve, sigurimeve shoq/shënd	3,534,860	3,851,848
Të pagueshme për detyrimet tatimore	826,403	8,522,451
Te tjera të pagueshme	27,822,094	
Totali	370,031,169	280,174,139

Analiza e detajuar e Llogarive të pagueshme afatshkurtra është:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
OSHEE	329,755,849	223,959,710
Bajrami	1,099,543	
2AT	350,760	1,649,520
UEVI 2015	0	10,234,560
Ergi	435,808	2,435,808
Diell shpk	0	15,018,452
Furnitor të ndryshëm	2,554,215	14,501,790
Fat Grup	3,651,638	
Totali	337,847,812	267,799,840

9 Llogari të pagueshme Personeli dhe tatime

Llogari te pagueshme të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Paga personeli	0	217,334
Detyrim sigurime shoqerore dhe shendetsore	3,534,860	3,578,720
Paradhenie punonjes		55,795
TVSh per tu paguar	379,010	8,096,545
Tatimi mbi te ardhurat	427,698	411,453
Tatim ne burim	19,695	14,445
Gjoba dhe interesa tatimore		8
Totali	4,361,263	12,374,300

10 Llogari të pagueshme të tjera

Llogari te pagueshme të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Taksa Bashkie te arketuara nga UK	15,898,794	10 821 560
Enti Regullator I Ujit	1,200,000	1 200 000
Debitor Cerriku	4,034,094	4 034 094
Detyrime Akt Kontrolli Tatimor	6,271,074	2 137 730
Detyrime te tjera	418,132	444 708
Totali	27,822,094	18 638 092

Te pagueshme te tjera per vitin 2018 jane netuar me detyrimet debitore dhe paraqitur per vler neto ne pasqyrat e vitit 2018.

11 Grante per investime

Grantet perfaqesojne financimin e Aktiveve Afatgjata Materiale nga Bashkia Elbasan dhe AKUM te vitit 2019.

Grantet jane klasifikuar ne Afatgjate dhe afatshkurter kuota e amortizimit qe do te rimeret ne vitin 2020. Grantet detajohen si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Grante viti 2019	511,329,875	14 979 042
Kesti afatshkurter i grantit	25,577,411	
Amortizimi i Grantit		14 979 042
Totali	485,752,465	0

12 Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 është 2,145,432,331 lekë (2018: 2,145,432,331 lekë) i zotëruar 100% nga Bashkia Elbasan.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Numri aksioneve	1	1
Vlera nominale (në lekë)	2,145,432,331	2,145,432,331
Totali (në lekë)	2,145,432,331	2,145,432,331

Kapitalet detajohen si me poshte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Kapitali	2,145,432,331	2,145,432,331
Prime te lidhura me Kapitalin	43,894,151	43,894,151
Rezerva Rivleresimi	35,252,094	37,107,467
Humbje e trashëguar nga bashkimi EKfshat	-353,008,701	-353,008,701
Fitim/Humbje te mbartura	36,308,703	-13,928,697
Fitim/Humbje e Vitit	-122,702,691	50,726,793
Totali	1,785,175,887	1,910,223,344

Primet e lidhura me kapitalin me 31.dhjetor 2019 paraqiten ne vlerën (43,894,151) lekë. Keto Prime trashëgohen nga UK Fshati.

Rezerva rivleresimit më 31 dhjetor 2019 në vlerën 35,252,094 lekë (2018: 37,107,467 lekë) është zvogëluar me 1,855,373 mijë lekë nga efekti i rimarjes se amortizimit te AAM te rivleresuara të shoqërise.

Humbjete trashëguara 31 dhjetor 2019 paraqitet ne Shumen 351,153,328 lekë (2018: 353,153,328 lekë)

Fitim/(Humbjet) e mbartura më 31 dhjetor 2019 janë vlerën 36,308,703 lekë (2018:(-13,928,697 +50,726,793)lekë).

Kjo llogari eshte prekur gjate vitit 2019 duke kaluar ne humbje taksat vendore te vitit 2016 dhe 2017 ne vlere 5,996,492 leke dhe ne fitim per vleren 5,507,099 leke per faturat e energjise te vitit 2017 te pa mbritura.

Rezultati I vitit eshte humbje 124,558,064 leke nga Fitim ne vitin 2018 ne vlere 50,726,793 leke.

13 Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga shitja e ujit	339,625,606	287 181 770
Vendosje matesi	803,871	228 322
Lidhje, rilidhje uji	2,218,100	3 463 339
Kliente per tarifa	436,000	781 667
Miratim planvendosje	457,833	375 000
Kliente per Prerje dhe Rilidhje	662,669	616 500
Totali	344,204,079	292,646,598

14 Puna e kryer nga njesia dhe qe kapitalizohet

Puna kryer nga njesia dhe e kapitalizuar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Puna e kryer nga njësia dhe qe kapitalizohet	2,751,945	2 590 551
Totali	2,751,945	2 590 551

Puna e kryer e kapitalizuar perfaqson investimet e kryera nga shoqeria ne rrjetet e saj.

15 Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga kamatat	10,791,619	14 198 416
Te ardhura nga tarifa e grumbullimit takses	4,949,812	3 430 236
Totali	15,741,431	17 628 652

16 Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lende e pare dhe materiale te konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 në vlerën 13,604,731 lekë (2018: 13,274,182 mijë lekë) paraqet shpenzimet qe kryen per blerjen e matrialeve te para qe perdoren per prodhim uji si dhe karburantit, , si dhe materiale te tjera te konsumueshme, qe i nevoiten procesit të prodhimit.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime materiale te para	11,198,326	11 385 195
Materiale ndihmese	520,000	521 678
Lende Djegse	1,886,405	1 189 989
Blerje uji		177 320
Totali	13,604,731	13,274,182

Ne krahasim me vitin 2018 kemi një rritje të shpenzimeve për lende të pare dhe materiale të konsumueshme në shumen 330,549 lekë. Kjo rritje paraqitet vetëm në zerin shpenzime për blerje uji dhe lende djegese si rezultat i shtimit të automjeteve të UK fshat.

17 Shpenzime Energji Elektrike

Shpenzimet e energjisë elektrike zënë një shumë të konsiderueshme në shpenzime ato paraqiten për vitin 2019 dhe 2018 si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Energji Elektrike	140,974,243	103,876,779
Totali	140,974,243	103,876,779

18 Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	130,083,796	97 363 508
Shpenzime për sigurime shoqërore shëndetësore	25,556,972	18 097 208
Shpenzime të tjera për personelin	22,973,854	11 952 150
Shpenzime antidode	765,900	
Totali	179,380,522	127,412,866

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, shpenzime të tjera për personelin si antidoda dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, shpërblime ushqimi.

19 Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

UJSJELLES KANALIZIMEELBASAN sh.a
Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha vlerat janë në lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Blerje Uji Cerrik	908,910	177,320
Qera Objekti	1,173,996	1,179,588
Mirmbajtje Automjetesh	1,072,000	3,634,173
Mirmbajtje te tjera	157,200	223,900
Avolxhime elektromotore	910,500	86,500
Siguracion mjete	599,538	549,250
Kerkime dhe studime	438,837	263,377
Te ndryshme	316,946	711,058
Punonjes te jashtem	1,155,674	845,324
Sherbime Auditimi & Avokatie	1,350,000	750,000
Sherbim pritimimi dhe mirmbajtje	3,022,191	0
Sherbim l rojeve civile	19,514,571	22,390,188
Publicitet reklama	35,000	20,000
Shpenzime postare	860,031	536,587
Sherbime interneti	779,012	557,950
Shpenzime transporti	792,800	499,860
Shpenzime sherbim bankar	96,765	118,081
Takse e regjistrimit	532,003	451,542
	0	
Totali	33,715,974	32,994,698

Tarifa e auditimit renduar ne shpenzimet e vitit 2019 eshte 1,350 mije leke pa tvsh.

20 Shpenzime Amortizimi dhe zhvleresimi

21 Shpenzimet e Amortizimit dhe Provizionet per kliente te pa arketuar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime amortizimi	97,170,768	84,541,916
Shpenzime Provigjon per klientet	26,212,612	8,000,000
Heqje detyrim klienti kaluar ne shpenzime		20 000 000
Totali	123,383,380	112,591,916

22 Të ardhura dhe shpenzime Financiare

Të ardhura dhe shpenzime financiare dhe të ngjashme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 detajohen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Te ardhura nga Grandet per matesa	12,448,524	0
Subvensione te shfrytezimit	8,322,500	37,294,852
Te ardhura nga arketimi I klienteve vite kaluara		93,492,698
Te ardhura nga interesat	3,005	6,059
Shpenzime interesi		-118,081
Shpenzime permbarimore paga	-4,918,880	-2,664,095
Gjoha nga akt kontrolli tatimor	-6,271,074	
Totali	9,584,075	128,011,433

23 Tatimi mbi fitimin

Shoqeria ka rezultuar me humbje dhe nuk ka llogaritur tatim ne fitim Humbja Fiskale llogaritet si me poshte:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Humbje periudhes ushtrimore	-124,558,064	50,726,793
Humbje e mbartur		-50,726,793
Shpenzime Provigjon per klientet	26,212,612	0
Gjoha dhe penalitete	11,189,954	0
Totali	-87,155,498	0

24 Te ardhurat Gjitheperfshirese

Shoqeria ka kaluar ne te ardhura gjitheperfshirese amortizimin e rivleresimit te AAM ne vlere

25 Transaksionet me palët e lidhura

Palë e lidhur konsiderohet një entitet që ka aftësinë të kontrollojë apo të ushtrojë një influencë të konsiderueshme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operacionale, apo palët janë nën kontroll të përbashkët me Shoqërinë. Një numer i caktuar transaksionesh me palë te lidhura janë ndermarrë gjatë aktivitetit operacional të shoqërisë. Këto transaksione janë financime ne rjetin e ujsjellesit qe eshte bere nga bashkia.

Volumi i këtyre transaksioneve sipas periudhave respektive janë si vijojnë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Bashkia Elbasan	17,768,960	0
Totali	17,768,960	0

26 Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Shoqëria UJSJELLES KANALIZIME ELBASAN sha, gjate vitit 2019 i është nënshtuar kontrollit financiar nga Drejtoria e Tatim Paguesve Elbasan për periudhën nga shtator 2014 – Shtator 2019. Shoqëria ka njojtur ne shpenzime detyrimet e aktit te kontrollit per vitin 2019 dhe ka kaluar ne humbje te viteve te kaluara detyrimet te periudhave te mepareshme.

Që nga 31 dhjetori 2019, përhapja e COVID-19 ka patur ndikim të rëndësishëm në shumë ekonomi lokale në mbarë globin. Në shumë vende, bizneset po detyrohen të ndërpresin ose kufizojnë operacionet për periudha të gjata ose të pacaktuara kohore. Masat e marra për të ngadalësuar përhapjen e virusit, të cilat përfshijnë ndalimet e udhëtimit, karantinat, distancimin shoqëror dhe mbylljen e shërbimeve jo thelbësore, kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme për bizneset në të gjithë botën, duke rezultuar në një ngadalësim ekonomik. Qeveritë dhe bankat qendrore janë përgjigjur me ndërhyrje monetare dhe fiskale për të stabilizuar kushtet ekonomike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka marrë një sërë masash në kuadër të ngadalësimit të përhapjes së virusit të cilat përfshijnë shtyrjen e kësteve të kredive për tre muaj për bizneset dhe individët të cilët kanë patur vështirësi ekonomike për shkak të masave të marra për ngadalësimin e përhapjes së virusit, shtyrjen e pagesave të qirave për tre muaj, si dhe një sërë masash për ndalimin e bizneseve që konsiderohen jo thelbësore dhe me rrezik për përhapjen e sëmundjes dhe kufizimin e lëvizjes së lirë të njerzve brenda fashave orare të përcaktuara.

Shoqëria ka përcaktuar që këto ngjarje janë ngjarje pas datës së bilancit të cilat nuk kërkojnë korrigjime. Prandaj, pozicioni financiar dhe rezultatet e aktiviteteve më dhe për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 nuk janë korigjuar për të pasqyruar ndikimin e tyre. Kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, si dhe efektiviteti i përgjigjeve të qeverisë dhe bankës qendrore, mbetet i paqartë në këtë kohë. Nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri kohëzgjatja dhe ashpërsia e këtyre pasojave, si dhe ndikimi i tyre në pozicionin financiar dhe rezultatet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Drejtimi i shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së aprovimit të pasqyrave financiare e cila mund të kërkojë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Nuk ka ngjarje të cilat kanë ndodhur pas datës së raportimit dhe që mund të kërkojnë rregullime apo informacione shtesë nga drejtimi i shoqërisë në lidhje me këto Pasqyra Financiare.